



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI**

Nr. 3150/9 Prot.

Pogradec, më 28.08. 2025

VENDIM

NR. 78, DATË 28.08.2025

**PËR AKORDIMIN E NDIHMËS FINANCIARE Z.LAVDIMIR BIBA,
FSHATI BUZAISHT, N.J.A. VELCAN, BASHKIA POGRADEC, PËR
HUMBJEN E JETËS SI PASOJË E RËNIES SË RRUFESË**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ligjit nr.45/2019, datë 18.07.2019 “ Për mbrojtjen Civile” dhe të kapitullit III të V.K..M Nr.329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, me propozim të kryetarit të Bashkisë.

KËSHILLI I BASHKIAK

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së Bashkisë Pogradec për mbështetje financiare të z. Lavdimir Biba, për shkak të humbjes së jetës nga rënia e rrufesë në datën 04.08.2025.
2. Miratimin e dokumentacionit tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Pogradec

3. Ti akordojë familjes së shtetit L.Biba ndihmën emergjente në vlerën prej 500.000 lekë nga buxheti I Bashkisë Pogradec, fondi I emergjencave civile I destinuar dhe I miratuar nga Këshilli I Bashkisë Pogradec për vitin 2025.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet drejtoria e Emergjencave Civile, Strehimi dhe Administrimit të Tokës Bujqësore në Njësitë Administrative , si dhe Drejtoria e Administrimit të Cështjeve Ekonomike dhe Financiare të
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZV/ KRYETAR E KËSHILLIT

Miranda OLLDASHI

1.Miratuar me 21 vota

2.Vota Pro 21

3.Vota Kundër 0

4.Vota Abstenim 0

5.Zbardhur më date 28.08.2025

